

Belsh Qendër, Iloji pasurisë pyll dhe pasurisë nr. 279/1, ZK, 1839 ,me certifikatë pronësie nr. 1611305, Belsh Qendër, Iloji pasurisë kullotë, në pronësi të Bashkisë Belsh.

5. Realizimi i aktivitetit të investimit me objekt: "Për qëllime pushimi dhe argëtimi "
6. Vendi i zhvillimit të konkurimit publik: Zyra e Këshillit Bashkiak (Adresa:) Rruga Haziz Dervishi, Belsh.
7. Informacion mbi dokumentet e konkurimit publik:
Dokumentet e konkurimit publik mund të tërhiqen pranë autoritetit kontraktor:
Bashkia Belsh, Zyra Juridike, kati 2 (dytë), nga e nesërmja e shpalljes së njoftimit në Agjensin e Prokurimit Publik. Dokumente me pagesë:

Po	X	Jo	
----	---	----	--

Nëse Po

Monedha	Leke	Çmimi	500
---------	------	-------	-----

Kërkesat për pjesëmarrje paraqiten dorazi ose me postë Brenda afatit dhe në zyrën e përcaktuar më sipër.

8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 16.11.2020 ora 10.00
9. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie është 10 (dhjetë) vjet.
10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet ofertues ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e zhvillimit të konkurimit.
Dokumentacioni duhet të paraqitet me zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkuresi me mbishkrim ofertë për dhënie me qera".

BASHKIA TROPOJË **NJOFTIM PER DHENIE ME QERA**

Autoriteti i dhënies me qera : Bashkia Tropojë njofton se në konkurimin publik të zhvilluar me datën 08.10.2020, ora 10.00 , publikimi i të cilit është bërë me datë 28.09.2020 në buletinin e njoftimeve publike nr.77 me objekt : dhënie me qera:

Fillimi i procedurave, për dhënien me qira me anë të konkurimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik, e njohur si "Shpatëzat" e fshatit Selimaj me siperfaqe 6 ha me afat përdorimi (qeraje) 10 vjet.

Çmimi dysheme për fillimin e konkurimit është 450 000 leke ne vit, sipas përcaktimit të VKM-se nr 1064, date 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave",si dhe vendimit të Këshillit Bashkiak Tropojë Nr.40 Prot datë 23.11.2019 "Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore 2020.

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1.Subjekti Ilir Musaj numri i NIPT-it M09307601D

Oferta e paraqitur për dhënien me qira të ekonomisë Pyjore "Lugina e Kolgecaje", pjese nga ngastra nr.15a dhe 16a te siperfaqes prej 6 ha " Për veprimtari turistike (bujtina)" me afat përdorimi (qiraje), 10(dhjetë) vite, është 450 000 (katërqindpesëdhjetëmijë) lekë në vit pa TVSH.

- S'ka të skualifikuar .

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:

1. Subjekti Ilir Musaj

- Adresa: Bashkia Tropojë, Bujan, Lagjja Shpatëz, fshati Selimaj, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 450 000 (katërqindpesëdhjetëmijë) lekë në vit është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Tropojë, me adresë Sheshi Azem Hajdari , Bajram Curri kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e konkurimit publik, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 16.10.2020

Ankesa: S'ka

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
PËR MARRJEN ME QIRA TË PASURISË NGA TË TRETËT PËR USHTRIM AKTIVITETI
DOGANOR NGA DEGA DOGANORE LEZHË

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton të interesuarit/konkurrentët se kërkon të marrë me qira godinë/objekt ndërtimor për ushtrimin e veprimtarisë doganore të Degës së Doganës Lezhë, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - Të jetë objekt ndërtimor me sipërfaqe rreth 330 m², e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë doganore;
 - Vendndodhja e zyrave të jetë në afërsi të Portit të Shëngjinit dhe lehtësisht e identifikueshme dhe objekti të ketë ambiente të përshtatshme për zyra, parkim automjesh dhe për agjensi doganore;
 - Të ketë sipërfaqe të mjaftueshme për mbarëvajtjen punës.
 - Duke u nisur nga rëndësia e Institucionit të jetë e përshtatshme për ruajtjen e sigurisë së ambjenteve;
 - Të jetë një objekt qëllimi i të cilit të jetë kryesisht për ambiente pune, jo godinë që ka destinacion bar apo hotel pasi nuk disponojmë fonde për përshtatjen e saj në zyra;
 - Në objekt të jetë i siguruar furnizimi pa ndërpreje energji elektrike, të ketë sistem ngrohje të instaluar, duke ditur se në Shëngjin ka ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike ;
 - Objekti të jetë i hipotekuar dhe të ketë një Gent Plan;
 - Të jetë një ndërtesë lehtësisht e përshtatshme për ambiente pune, pasi Dega Doganore Lezhe nuk disponon fonde për përshtatjen e saj për zyra;
 - Vlera fillestare për konkurrim është 99,792 lekë (nëntëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë referuar VKM-së 469 datë 03.06.2015.
2. Ofertat që do të paraqesin konkurrentët për konkurrim përbëhet nga dokumentacioni i mëposhtëm:
 - a. kërkesa e subjektit për pjesëmarrje në konkurrim;
 - b. deklarata e hollësishme për vënien në funksionim të objektit, për veprimtari doganore;
 - c. oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
 - d. formulari i sigurimit të ofertës në vlerën 2% të VFQ. Sigurimi i ofertës është i vlefshëm për 100 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.
 - e. vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të